

Procedurat dhe mekanizmat për të bërë kërkesë dhe ankesë që lidhen me veprimet ose mosveprimet e QPKMR - së, (Përfshirë adresën postare/elektronike për depozitimin e kërkesave dhe ankesave - Afatet dhe mënyrën e kthimit të përgjigjeve).

Në bazë të Nenit të Ligjit nr 119/2014 *“Për të Drejtën e Informimit”* cdo person ka të drejtë të sjellë pranë QPKMR-së kërkesa apo ankesa që lidhen me fushën e veprimtarisë së QPKMR-së, sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave vendimit nr. 314, datë 15.5.2019, *“Për organizimin, funksionimin, si dhe përcaktimin e rregullimeve specifike lidhur me strukturën dhe organikn e Qendrës së Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve”*, të ndryshuar.

Neni 11 i ligjit nr 119/2014 *“Për të Drejtën e Informimit”* përcakton hapat që ndiqen si më poshtë:

Kërkesa për informim:

1. Kërkesa për informim bëhet me shkrim dhe dërgohet dorazi, me postë ose me postë elektronike, duke paraqitur saktë identitetin e kërkuarit dhe nënshkrimin e tij. Në çdo rast, kërkesa regjistrohet në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve, të parashikuar në nenin 8 të këtij ligji.

2. Në çdo rast, kërkesa për informim regjistrohet dhe për të caktohet një numër rendor. Numri rendor, së bashku me të dhënat e kontaktit të koordinatorit për të drejtën e informimit, i jepen kërkuarit që ka bërë kërkesën për informim.

3. Kërkesat për informim regjistrohen sipas radhës së paraqitjes dhe trajtohen pa dallime mes tyre.

4. Kërkesa për informim duhet të përmbajë:

a) emrin dhe mbiemrin e kërkuarit;

b) adresën postare ose elektronike ku kërkohet të dërgohet informacioni;

c) përshkrimin e informacionit që kërkohet;

ç) formatin në të cilin preferohet informacioni;

d) çdo të dhënë që kërkuari gjykon se mund të ndihmojë në identifikimin e informacionit të kërkuar.

5. Në qoftë se kërkesa për informim nuk e përcakton formatin në të cilin kërkohet informacioni, ai jepet në mënyrën më të efektshme dhe me koston më të ulët për autoritetin publik.

Në web-in e institucionit janë të publikuar adresa zyrtare e emailit të QPKMR-së si dhe të dhënat e kontaktit të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit, adresa e Institucionit në të cilat publiku mund të depozitojë kërkesat/ankesat.